

VENDIMET E KUVENDIT TË DATËS 24 NËNTOR 2018

Vendimi Nr. 2018-12

Kuvendi me shumicë votash mori vendim:

1. Të emërojë kompaninë audituese *Grant Thornton* si auditor të jashtëm për auditim të pasqyrave financiare të Federatës për vitet 2018-2020.
2. Kushtet financiare sipas ofertës së auditorit.

Vendimi Nr. 2018-13

Kuvendi me shumicë votash mori vendim:

1. Të miratojë Raportin e Punës 2018 dhe Raportin Preliminar Financiar 2018 të paraqitur në Kuvend.
2. Raportet e sipërpërmendura t'i dërgohen të gjithë anëtarëve dhe komunitetit të tenisit.
3. Raporti përfundimtar financiar, i audituar, të finalizohet deri më 31 mars 2019 dhe të publikohet.

Vendimi Nr. 2018-14

Kuvendi me shumicë votash mori vendim:

1. Të miratojë Planin e Aktiviteteve dhe Buxhetin 2019 të prezantuar në Kuvend (Shtojca 1).
2. Plani t'i dërgohet të gjithë anëtarëve dhe komunitetit të tenisit.

Vendimi Nr. 2018-15

Kuvendi me 2/3 e votave mori vendim:

1. Të miratojë Statutin e ri të datës 24 nëntor 2018.
2. Statuti i ri të shfuqizojë Statutin e datës 14 janar 2012, me përjashtim të dispozitave kalimtare siç i parasheh Statuti i ri.

Vendimi Nr. 2018-16


Kuvendi me 2/3 e votave mori vendim:

1. T'i klasifikojë si Anëtarë joaktivë të Federatës, me të drejtë prej vetëm 1 delegati/vote, klubet: a) K.T. Rahoveci; b) K.T. Gjilani 99; c) T.K. Gracanica; dhe d) T.K. Laki, Mitrovicë V.
2. Të përjashtojë nga Federata klubin e shuar K.T. Sesahr USA nga Prizreni.

Vendimi Nr. 2018-17

Kuvendi me shumicë votash mori vendim që deri në zgjedhjet e ardhshme të rregullta:

1. Ta emërojë si nënkryetare znj. Elida Ramadani.
2. T'i emërojë si anëtarë Bordi: a) znj. Sevëm Gjinaj; b) znj. Mërgime Mula; c) z. Blerim Koro.


Mejdi Rexhepi, Kryetar

